



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.17, datë 16.01.2023

PËR

**“CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR VIJIMIN E PROCEDURËS SË
NGRITJES NË DETYRËN E DREJTUESIT PËR KANDIDATIN KLEDIAN LLAHO”**

Bazuar në nenet 159 pika 2 germa “i”, 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “ç”, 190 të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 52 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 19 pika 1 e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin me short të zotit Bujar Sheshi, si relator për vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë të drejtuesit, për kandidatin Kledian Llaho që ka kandiduar për vendin vakant të drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KRYETAR

